

## Pyetjet më të shpeshta

### FAQ (frequently asked questions)

#### a. Kush mund të përfitojë?

Mbështeten me grant *startup*-et që i përkasin tre kategorive kryesore : *startup*-et në fazën fillestare, në fazën e rritjes dhe në fazën e zgjerimit dhe gjithashtu lehtësuesit e *startup*-eve të kategorive si: akademia, e cila përfshin universitete private dhe publike, bashki, arsim i mesëm dhe profesional, inkubatorë dhe përsheptues, hapësira të përbashkëta pune, të cilat përfshijnë ofruesit e ambienteve dhe pajisjeve të punës dhe organizues eventesh për *startup*-et.

#### b. Si mund të aplikoj?

Hapi i parë konsiston në kryerjen e vetëdeklarimit në regjistrin elektronik të *startup*-eve dhe të lehtësuesve i cili kryhet në e-albania dhe aksesohet në linkun:

[https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service\\_code=14900](https://e-albania.al/eAlbaniaServices/UseService.aspx?service_code=14900)

Brenda 48 orëve nga deklarimi *startup*-i/lehtësuesi, pajiset me pasaportën përkatëse e cila i vjen në hapësirën “Mesazhet e mia” në platformën e-albania.

Pas kësaj procedure mund të plotësohet formulari i aplikimit dhe formati i buxhetit, të cilat shkarkohen në linkun: <https://sipermarrja.gov.al/dokumentet-e-aplikimit/>. Bashkë me dokumentet e tjera shoqëruese sipas përcaktimeve në Rregullore, aplikuesi i dërgon në adresën e emailit: [startup@sipermarrja.gov.al](mailto:startup@sipermarrja.gov.al). Subjekti i emailit duhet të jetë: “aplikim *startup*”, nëse aplikuesi është *start-up* ose “aplikim lehtësues”, nëse aplikuesi është lehtësues.

#### c. Cilat janë dokumentet e detyrueshme për aplikim për *startup*-et?

Dokumentet që duhet të dërgojë me email aplikuesi *startup*, janë si më poshtë:

1. Formulari i aplikimit i plotësuar;

2. Formati i buxhetit i plotësuar;
3. Pasaporta e *startup*-it;
4. Dëshmi e përfundimit ose ndjekjes në proces të një programi inkubimi ose përsheptimi ose rekomandim nga një ekspert i fushës.
5. Dokumenti i regjistrimit në organin tatimor (NIPT) në rastin e personave fizikë ose juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar;
6. Bilanci i vitit paraardhës për aplikuesin person fizik ose juridik të regjistruar mbi 1 vit në regjistrin tregtar;
7. CV-të e anëtarëve të grupit të punës, përgjegjës për zbatimin e aktiviteteve të aplikimit;
8. Vërtetim për pagim detyrimesh, i marrë nëpërmjet portalit e-albania;
9. Dëshmi penaliteti e aplikuesit, i marrë nëpërmjet portalit e-albania.
10. Çdo dokument tjetër shoqërues që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin e tij/saj.

**d. Cilat janë dokumentet e detyrueshme për aplikim për lehtësuesit e startup-eve?**

Dokumentet që duhet të dërgojë me email aplikuesi lehtësues i startup-eve, janë si më poshtë:

1. Formulari i aplikimit i plotësuar;
2. Pasaporta e lehtësuesit;
3. Certifikata e regjistrimit në organin tatimor (NIPT);
4. Ekstrakti i QKB;
5. Akt themelimi dhe statut;
6. CV-të e anëtarëve të grupit të punës, përgjegjës për zbatimin e projektit;
7. Vërtetim nga Drejtoria e Tatim Taksave që aplikuesi, nuk ka detyrime të pashlyera për sa i përket kontributeve për sigurimet shoqërore, sigurimet shëndetësore dhe tatim-taksat;
8. Kopje të ID të aplikuesit;
9. Dëshmi Penaliteti e Drejtuesit Ekzekutiv ose Administratorit;
10. Çdo dokument tjetër shoqërues që në vlerësimin e aplikuesit mbështet aplikimin e tij/saj.

**e. A është e detyrueshme pasaporta e startup-eve dhe e lehtësuesve për aplikim?**

Po. Pasaporta e startup-eve dhe e lehtësuesve është kusht i domosdoshëm për aplikim. Në rast se vetëdeklarimi në e-albania nuk kryhet dhe nuk gjenerohet pasaporta, apo nuk dërgohet në emailin e aplikimit së bashku me dokumentet e tjera të kërkuara, aplikimi skualifikohet.

**f. Cilat janë aplikimet për të cilat mund të përfitojë një Startup?**

Përsa i përket rasteve kur aplikuesi është Startup, mund të përfitojë mbështetjen me grant për:

1. pjesëmarrje në aktivitete (pagesë e pjesëmarrjes, biletë vajtje-ardhje avioni dhe akomodim), por jo më shumë se 500,000 lekë në total;
2. pjesëmarrje në konkurse (biletë vajtje-ardhje avioni dhe akomodim), por jo më shumë se 500,000 lekë në total;
3. pjesëmarrje në panaire ndërkombëtare, jo si vizitor (pagesë e pjesëmarrjes, biletë vajtje-ardhje avioni dhe akomodim), por jo më shumë se 500,000 lekë në total;
4. pjesëmarrje në programe ndërkombëtare inkubimi deri në 3 muaj (pagesë e pjesëmarrjes, biletë vajtje-ardhje avioni dhe akomodim), por jo më shumë se 500,000 lekë në total;
5. rritje aftësish/kapacitete teknike;
6. blerje makinerish dhe/ose pajisje pune;
7. zhvillimi i tregtisë elektronike dhe/ose *software*;
8. patenta dhe licenca;
9. lëndë e parë dhe ambalazhim/etiketim produkti.

**g. Cilat janë aplikimet për të cilat mund të përfitojë një Lehtësues?**

Në rastet kur aplikuesi është Lehtësues, mund të përfitojë mbështetje me grant për:

1. infrastrukturë për krijimin e ambienteve dhe programeve të inkubatorëve;
2. rritje kapacitetesh për stafin e universiteteve (por jo më shumë se 500.000 lekë të reja);
3. hapësirë e përbashkët pune në shërbim të studentëve që kanë një ide biznesi;
4. dhomë projektesh me sistem rezervimi online;
5. konkurse kombëtare për *startup*-et (të përshkallëzuara nga kombëtare në ndërkombëtare);
6. evente trajnimi për *startup*-et me shtrirje kombëtare në bashkëpunim me të paktën një partner ndërkombëtar;

7. evente ndërgjegjësimi për *startup*-et me shtrirje kombëtare në bashkëpunim me të paktën një partner ndërkombëtar (por jo më shumë se 500.000 lekë të reja);
8. shërbime mbështetëse, ekspertizë, shkëmbim njohurish për *startup*-et nga ekspertë ndërkombëtarë;
9. evente ndërkombëtare në hapësirën e përbashkët të punës me një audiencë me më shumë se 100 persona;
10. akademi inovacioni për të rinjtë dhe bizneset (njohjen me teknikat e projektimit, gjenerimit të idesë, teknologjitë e reja dhe aplikimin e tyre në biznes).

**h. A mund të aplikoj me dy projekte të ndryshme?**

Jo. Një aplikues nuk mund të paraqesë më shumë se një aplikim brenda kësaj thirrje.

**i. Sa është masa e grantit që mund të përfitohet për një aplikim?**

Startup-et përfitojnë grant si më poshtë:

1. *Startup*-et në fazën fillestare përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
2. *Startup*-et në fazën e rritjes përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 3,000,000 (tre milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
3. *Startup*-et në fazën e zgjerimit përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 5,000,000 (pesë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.

Lehtësuesit e Startup-eve përfitojnë grant si më poshtë:

1. Akademia, e cila përfshin universitetet publike dhe private, përfiton mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10,000,000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 90% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
2. Lehtësuesit si inkubatorët dhe përshpejtuesit, përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10,000,000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.

3. Hapësirat e përbashkëta të punës përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10, 000, 000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
4. Bashkitë, përveç Bashkisë së Tiranës, përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 20, 000, 000 (njëzet milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 90% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
5. Organizuesit e eventeve, përfitojnë mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10, 000, 000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 80% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.
6. Arsimi parauniversitar, i cili përfshin shkollat e mesme dhe shkollat profesionale publike dhe private, përfiton mbështetje financiare deri maksimalisht në masën 10, 000, 000 (dhjetë milion) lekë për projekt dhe mbulohen maksimalisht 90% të kostove të pranueshme dhe të miratuara.

**j. Si kryhet disbursimi i grantit?**

Disbursimi i grantit, për projektet e shpallura fituese, bëhet deri në 3 këste, pas përfundimit të periudhës së mbylljes së çdo faze të projektit, kundrejt dorëzimit të faturës/ave të shpenzimeve të kryera dhe dokumentacionit të kërkuar sipas procedurave dhe kritereve të përcaktuara në rregullore.

Vetëm për fituesit e kategorisë lehtësues si akademi, bashki dhe shkollat e mesme dhe profesionale do të bëhet para-financim sipas fazave të rëna dakord në kontratë.

**k. A përfitoj mbështetje nëse investimin/idenë e kam kryer por aplikoj edhe në këtë thirrje?**

Jo. Investimi/ideja nuk mund të realizohet para firmosjes së Kontratës së Grantit. Çdo aplikim i kryer para kësaj date, nuk mbështetet nga kjo thirrje.

**l. Sa afat do të kem në dispozicion për realizimin e projektit?**

Periudha maksimale e realizimit të projektit është 5 muaj. Kjo periudhë saktësohet në Kontratën e grantit të lidhur midis përfituesit dhe Ministrit përgjegjës për sipërmarrjen.